



Nr. 771 -Regj.

Tiranë më 20.06.2016

Lenda : Kërkohet të kryet shënimi i bllokimit të aktiveve që ka pala debitore

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

TIRANË

Për dijëni : Shoqëria "DIZOTI" sh.p.k, Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k
SHKODËR

Pranë shërbimit përmbarimor "Power & Justice" (P&J) sh.p.k me kërkesë të palës kreditore janë paraqitur për ekzekutim titujt ekzekutiv me palë:

Kreditor : Raiffeisen Bank sh.a

Debitor : Shoqëria "Dizzoti" sh.p.k Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k

Dorezanes : Eduard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Çesk Kimca

Me objekt : Kthim Shume (Kredi Bankare)

Une përmbaruesi gjyqësor Ilir Dervishaj pasi shqyrtova materialin e dosjes përmbarimore

KONSTATOVA

Në titullin ekzekutiv titullit Kontratë Kredie Bankare Nr. 2589 rep, nr. 1320 kol, datë 13.07.2012 të ndryshuar, është përcaktuar detyrimi i palës debitore Shoqëria "Dizzoti" sh.p.k bashkredimarrësit Sh" Meat Master Vllezerit Kimca" sh.p.k si dhe palëve dorëzënëse Eduard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Çesk Kimca, të paguajnë në favor të palës kreditore Raiffeisen Bank sh.a shumën e marrë kredi së bashku me interesa në masën 603.323.41 Euro.

Për këtë titull ekzekutiv nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është lëshuar Urdhëri i ekzekutimit Nr.642 Akti, datë 05.02.2016 si dhe pala kreditore ka kërkuar ekzekutimin e tij. Në këto kushte në bazë të ligjit është përgatitur dhe dërguar me shërbimin postar njoftimi për ekzekutim vullnetar ndaj palës debitore dhe atyre dorëzënëse. Por nga ana e shërbimit të Postës Shqiptare zarfat janë kthyer mbrapsh dhe për rrjedhojë me cilësinë e përmbaruesit gjyqësor është vajtur në Buashat Shkodër ku është bërë dhe komunikimi i akteve palës debitore dhe atyre dorëzënëse. Më pas pala debitore që nga marja e njoftimit vullnetar e deri me sot nuk është vepruar dhe për rrjedhojë afati për ekzekutim vullnetar ka përfunduar. Në këto kushte ekzekutimi i titullit ekzekutiv ka kaluar në ekzekutimit të detyrueshëm duke urdhëruar vendosjen e masës së sekuestros mbi llogaritë e palës debitore në Bankat e Nivelit të Dytë si dhe në bazë të nenit 560 të K.Pr.Civile është vendosur masa e sekuestros mbi pasuritë e paluajtëshme të palës debitore të vendosur si garanci në hipoteke në favor të palës kreditore "Raiffeisen Bank" sh.a. Në këto kushte është e nevojshme që të vendoset shënimi i bllokimit të aktiveve të shoqërisë debitore të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit me qëllim mostjetërsimin e tyre.

Për këto arsye :

Në bazë të Nenit 527 e vijues te K.Pr.Civile si dhe nenit 46 te ligjit nr.10031 date 11.12.2008 "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat".

URDHËROJ

Vendosjen e shënimit në regjistrat tuaj, **për bllokimin e aktiveve të palës debitore Shoqeria “ Dizzoti” sh.p.k** me numur niptit K 46818008 U, perfaqesuar nga ortaku dhe administrator i shoqërisë Znj. Enrisa Ritani , me seli në Bushat Shkoder , me qëllim mos tjetërsimin e tyre.

Vendosjen e shënimit në regjistrat tuaj, **për bllokimin e aktiveve të palës debitore Shoqeria Sh” Meat Master Vllezerit Kimca” sh.p.k** me Nipt K 06527025 T sh.p.k me numur niptit K 46818008 U, perfaqesuar nga ortaku dhe administrator i shoqërisë Cesk Kimca , me seli në Zona Industriale Shkoder , me qëllim mos tjetërsimin e tyre

Aktivitetet e të dy shoqërive do të qendrojnë të bllokuara deri në shlyerjen e plotë të detyrimit.

Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

Për personat që behen pengese në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në nenin 598 e në vijim të K.Pr.Civile.

Ky urdhër u njoftohet palëve të cilat në bazë të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marrja e tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

Shenim : Bashkëlidhur fotokopje të Urdhërit të Ekzekutimit.

PËRMBARUESI GJYQËSOR


Ilir S. DERVISHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR



Nr. 642 Akti

V E N D I M

“PËR LËSHIMIN E URDHËRIT TË EKZEKUTIMIT”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përberë prej :

GJYQTARE: ASTRIT FAQOLLI

Asistuar prej sekretares gjyqësore NAJADA MUSTAFA, sot më dt. 05.02.2016, mbaroi së shqyrtuari në seancë gjyqësore publike çështjen civile me :

KËRKUES: **“Raiffeisen Bank” Sha**, me adresë Rr “Kavajës” Tiranë, regjistruar në regjistrin tregtar me vendimin Nr 17426 datë 10/07/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga z. **Enel Cinije** me autorizimin e dates 21.01.2015.

OBJEKTI: Kërkesë për lëshimin e urdhërit të ekzekutimit Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014.

BAZA LIGJORE: Neni 510/d dhe 511 të K.Pr.Civile

Gjykata në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore, dëgjo pretendimet përfundimtare të përfaqësuesit së kërkuesit, i cili kërkoi pranimin e kërkesës, lëshimin e urdhërit të ekzekutimit për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014, shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Se kërkuesi "Raiffeisen Bank" Sh.a, përfaqësuar në gjykim nga juristi Enel paraqitur për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesën për e urdhërit të ekzekutimit për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014 të lidhur midis "Raiffeisen Bank" Sh.a dhe kredimarrësve Shoqërië "Dizotti" Sh.p.k dhe bashkëkredimarrësit Shoqëria "Meat Master Vëllezrit Kimca" Sh.p.k dhe Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (Dorezanesit).

Si garanci për të siguruar ekzekutimin e kësaj kredie janë dhe Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (Dorëzanesit) të cilët kanë nënshkruar kontratën e kredisë bankare bashkë me kredimarrësin duke garantuar Bankën se do të pergjigjen për përmbushjen e detyrimit total të kredimarrësit në rast mospërmbushje nga ana e këtij të fundit.

Përpara shqyrtimit të bazueshmërisë në ligj dhe prova të kërkesës, gjykata analizoi juridiksionin dhe kompetencën e saj në gjykimin e kësaj çështjeje. Në bazë të Neneve 36/1, 41, 59, 510/d dhe 511/ç të K.Pr.Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kompetencën e saj, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe është në kompetencën e saj lëndore e tokësore. Gjykata, gjithashtu në vështrim të Neneve 71, 72, dhe 73 të K.Pr.Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pakundështuar dhe nga kërkuesi në gjykim. Në bazë të Nenit 35 të K.Pr.Civile, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:

Raiffeisen Bank Sh.a ka lidhur me Shoqërinë "Dizotti" Sh.p.k (kredimarrësi) dhe Shoqërinë "Meat Master Vëllezrit Kimca" Sh.p.k, (bashkëkredimarrës), dhe me Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (në cilësinë e dorëzanesve), Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014, për shumën 600.000 (gjashtë qind mije) Euro, për një afat jo me vone se data 30 Prill 2015. Në Nenet 3 dhe 4 të kontratës është përcaktuar mënyra e shlyerjes së kredisë, principalet dhe interesat. Debitoret nuk e kanë realizuar shlyerjen korrekte të pagesave të kësteve të kontratës në mënyrën që palët kanë rënë dakort sipas kontratës. Nga ana e Bankës janë bërë të gjitha përpjekjet për shlyerjen e kontratës, por nuk është bërë i mundur realizimi i shlyerjes së saj duke rezultuar debitorë Shoqëria "Dizotti" Sh.p.k (kredimarrësi) dhe Shoqëria "Meat Master

Vëllezrit Kimca” Sh.p.k, (bashkëkredimarrës), dhe me Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (Dorëzanesit) në shumën totale **603,319.41 Euro** sipas përfundimeve të bëra nga Raiffeisen Bank Sh.a.

Cilësia e titullit ekzekutiv, në kuptim të dispozitave procedurale mbi ekzekutimin e detyrueshëm e kanë vetëm aktet e përcaktuara sipas Nenit 510 të K.Pr.Civile. Për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014 të lidhur midis “Raiffeisen Bank” Sh.a dhe kredimarrësit Shoqëria “Dizotti” Sh.p.k dhe bashkëkredimarrësit Shoqëria “Meat Master Vëllezrit Kimca” Sh.p.k, dhe Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (Dorëzanesit) sipas pikës “d” të Nenit 510 të K.Pr.Civile kjo kontratë **përbën titull ekzekutiv**. Gjykata arriti në këtë përfundim pasi analizoi faktin dhe provat dhe në bazë të nenit të sipërpërmendur çmoi se ajo përbën titull ekzekutiv.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, gjykata vendos të pranojë kërkesën si të bazuar në ligj dhe në prova dhe të lëshojë urdhërin e ekzekutimit për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014 të lidhur midis “Raiffeisen Bank” Sh.a dhe kredimarrësit Shoqëria “Dizotti” Sh.p.k dhe bashkëkredimarrësit Shoqëria “Meat Master Vëllezrit Kimca” Sh.p.k, dhe Z. Edoard Rrotani, Z. Ardjan Kimca, Z. Cesk Kimca (Dorëzanesit).

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në Nenet 306 e vijues të K.Pr.Civile dhe Nenet 510/ d 511/ç të K.Pr.Civile

VENDOSI:

- Lëshimin e urdhërit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014, lidhur midis kredimarrësit **“Raiffeisen Bank” Sha** dhe kredimarrësit **Shoqëria “Dizotti” Shpk**, me bashkëkredimarrës **Shoqëria “Meat Master Vëllezërit Kimca” Shpk**, dhe me dorëzanës **Edoard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Cesk Kimca**.
- Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.
- Urdhërimin e Shërbimit Përmbarimor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv.

- Ky vendim lëshohet vetëm në një kopje.
- Ky vendim është i formës së prerë.
- U shpall sot më datë **05.02.2016** në Tiranë.

SEKRETARE
NAJADA MUSTAFA

GJYQ TAR
ASTRIT FAQOLLI

SHPENZIMET GJYQËSORE	
Kërkesë	200 Lekë
Njoftime	100 Lekë
Gjithësej	300 Lekë



Nr 486 Akti

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga:

GJYQTAR: ASTRIT FAQOLLI

asistuar nga sekretare gjyqësore **NAJADA MUSTAFA**, sot më datë **12.05.2016** mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile me Nr **486 Regj.** Themeltar që i përket:

KËRKUES:

“Raiffeisen Bank” Sha, me adresë Rr “Kavajës” Tiranë, rregjistruar në regjistrin tregtar me vendimin Nr 17426 datë 10/07/1997 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar në gjykim nga z. **Dorjan Çeliku** me autorizimin e datës 03.05.2016, i identifikuar me ID-ne me Nr 024471107 , dhe Nr H 60521138 R.

OBJEKTI:

Ndreqe e gabimit te Vendimit Nr. 642 datë 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE:

Neni 312 e vijues i K.Pr.Civile.

Gjykata pasi dëgjoji pretendimet e kërkuarit i cili kërkoi pranimin e kërkesës, pasi administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çështjen në tërësi, në përfundim të saj,

VËREN :

Se pala kërkuese “Raiffeisen Bank” Sha i është drejtuar kësaj Gjykate dhe ka kërkuar të ndreqet gabimi që është bërë në Vendimin Nr. 642 Regj. Themeltar datë 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të gjitha pjesët e vendimit lidhur me Kontratën e Kredisë me Kufi me Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012, duke e ndrequr atë në Kontratën e Kredisë me Kufi me Nr. **2598 Rep** dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012.

Në bazë të Nenit 36, 41, 59, 312 të K. Pr.Civile, gjykata pasi shqyrtoi nëse çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kompetencën e saj lëndore e tokësore, konstatoi se çështja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykatë është kompetente nga pikëpamja lëndore e tokësore.

Kërkuesi në bazë të Neneve 312, 388 paragrafi i parë të K.Pr.Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me këtë kërkesë, në bazë të së cilës është përfitojë të drejta dhe detyrime juridiko – civile. Në bazë të Nenit 35 paragrafi i parë, gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.



Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi e provuar se:

Pala kërkuese “Raiffeisen Bank” Sha ka qënë në pozitën procedurale të kërkuesit në çështjen civile me Nr. 642 Regj. Themeltar datë 05.02.2016. Në këtë vendim gjykata ka vendosur:

“Lëshimin e urdhërit për ekzekutimin e titullit ekzekutiv për Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012 ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2289 Rep dhe Nr. 1426 Kol datë 05.09.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 5326 Rep dhe Nr. 2211 Kol datë 05.11.2013, ndryshuar me Kontratën e Kredisë me Kufi Nr. 2366 Rep dhe Nr. 843 Kol datë 26.08.2014, lidhur midis kredidhënësit “Raiffeisen Bank” Sha dhe kredimarrësit Shoqëria “Dizzoti” Shpk, me bashkëkredimarrës Shoqëria “Meat Master Vëllezërit Kimca” Shpk, dhe me dorëzanës Edoard Rrotani, Ardjan Kimca dhe Cesk Kimc”.

Ndërkohë që gjykata në pjesën arsyetuese dhe në dispozitivin e saj Nr e Rep të Kontratës së Kredisë me Kufi, gabimisht e ka pasqyruar 2589 Rep.

Për të provuar këtë pretendim gjykata terhoqi fashikullin e vendimit Nr. 642 Regj. Themeltar datë 05.02.2016, ku nga verifikimi i kontratës së kredisë me kufi rezultoi se ky Nr i Rep të kontratës datë 13.07.2012 është Nr 2598.

Neni 312 i K.Pr.Civile përcakton se: *“Pas shpalljes së vendimit gjykata nuk mund ta anulojë ose ta ndryshojë atë. Ajo me kërkesën e palëve ose kryesisht mund të ndreqe në çdo kohë vetëm gabimet e bëra me shkrim ose në llogari ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit. Gjykata pasi thërret palët, në seancë e shqyrton kërkesën sipas rregullave të këtij kodi, jep vendim i cili i bashkohet vendimit të ndrequr”.*

Në interpretim të këtij neni gjykata çmon se së pari është ajo kompetente dhe ka tagrin ligjor të ndreqë këtë vendim, konkretisht vendimin Nr. 642 Regj. Themeltar datë 05.02.2016 të dhënë nga Gjykata e Rrethit Tiranë. Së dyti legjislatori këtë ndreqje gabimi nuk e ka lidhur me ndonje afat ligjor brenda të cilit duhet të bëhet kjo ndreqje ; së treti gjykata çmon se në vendimin Nr. 642 Regj. Themeltar datë 05.02.2016, në referim të provave të paraqitura nga pala kërkuese u gjet i provuar se Nr i Rep të kontratës së kredisë me kufi datë 13.07.2012, në këtë vendim është shkruajtur gabimisht Nr 2589 Rep dhe duhet të ndreqet si i tillë, konkretisht Nr. 2598 Rep si në pjesën arsyetuese dhe në pjesën e dispozitivit të vendimit.

Në këto kushte, gjykata çmon se kërkesa e pala kërkuese Raiffeisen Bank Sha është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar në Nenet 126 e 312 të K. Pr. Civile,

VENDOSI

Pranimin e kërkesës .

Ndreqjen e gabimit material në Vendimin me Nr. 642 Akti, datë 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në të gjitha pjesët e vendimit lidhur me Kontratën e Kredisë me Kufi me Nr. 2589 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012, duke e ndrequr atë në Kontratën e Kredisë me Kufi me Nr. 2598 Rep dhe Nr. 1320 Kol datë 13.07.2012.

- Ky vendim i bashkangjitet Vendimit Nr. 642 Regj.Themeltar, dt. 05.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Shpenzimet siç janë bërë.
- Kundër këtij vendimi lejohet të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit Tirane brënda 5 ditëve, afat që fillon nga e nesërmja e shpalljes.
- U shpall sot më 12.05.2016 në Tiranë.

SEKRETARE
NAJADA MUSTAFA



SHPENZIMET GJYQËSORE	
Kërkesë	200 Lekë
Njoftime	100 Lekë
Gjithësej	300 Lekë

Vendimi mori formë të prerë pasi
u kërkua me dt 12.05 2016
Trans me dt 23.05 2016

K/SEKRETARE

Mirnoza CENAJ (LULAJ)

KANCELAR
DONALD XHELILI

